

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 590 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

**VENDIM Nr. 55, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike* në kuadër të projektit "*BY-PAS Vlorë*" paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "KAEXH" SH.P.K.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Relacionin mbi konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike* në kuadër të projektit "*BY-PAS Vlorë*" paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "KAEXH" SH.P.K.
2. ARRSH për kryerjen e sondazheve arkeologjike në zonën *nga km 10+420 deri në km 12+100, që përkon me hyrjen e fshatit Kaninë*, në kuadër të projektit "*BY-PAS Vlorë*", sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji "KAEXH" SH.P.K., duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

